
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ .2026

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË
MARRËVESHJEN KUADËR, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË AFATET E
ANKIMIMIT**

Data: 01.04.2026

Drejtuar:

Operatorit Ekonomik (OE) ose

Operatorit Ekonomik “AIR” SHPK me nr. NIPTI L51712008C, me adresë: “Rruga “Siri Kodra”, Nr. 8340, Nr. Pasurie 5/450, Njësia Administrative Nr.8, Tiranë

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE)

[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]

- OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

Operatori ekonomik “S I L V E R”, me NIPT: K88010301S, me adresë: Njësia Bashkiake nr.5, Rruga Bajram Curri, Pallati Palma e Artë, Kati 1-re, Tiranë

* * *

Tipi i Kontratës: Shërbime

Lloji i Procedurës së prokurimit: Procedurë e kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar, Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: **REF-62426-09-23-2025**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “**Shërbim Pastrimi për Spitalin Universitar të Traumës**”, me fond limit **245,035,563.59** (dyqind e dyzet e pesë milion e tridhjetë e pesë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre pikë pesëdhjetë e nëntë) Lekë, pa TVSH ose **2,530,574.86** (dy milion e pesëqind e tridhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër pikë tetëdhjetë e gjashtë) Euro pa TVSH, me afat **36** (tridhjetë e gjashtë) muaj nga nënshkrimi i marrëveshjes kuadër.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: **Data 24.09.2025**

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike: **Data:29.09.2025**, Numri: **55**

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar:

1. Operatori ekonomik “AIR” me NIPT: **L51712008C**
Emri i plotë i shoqërisë *Numri i NIPT-it*

Me subjekt mbështetës:

Operatori ekonomik “S I L V E R”, me NIPT: K88010301S

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në fazat e tjera të procedurës së sipërcituar (faza e dytë) këta ofertues:

1. Operatori ekonomik “AIR” me NIPT: **L51712008C**
Emri i plotë i shoqërisë *Numri i NIPT-it*

Me subjekt mbështetës:

Operatori ekonomik “S I L V E R”, me NIPT: K88010301S

Vlera e ofruar: 243,017,617.96 (dyqind e dyzetë e tre milion e shtatëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë pikë nëntëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar (në fazën e parë), ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “REJ” me NIPT J93711608Q
Emri i plotë i shoqërisë *Numri i NIPT-it*

Arsyet e skualifikimit:

Sipas Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik (KPP) nr. 104/2026, datë 20.01.2026
1. Operatori ekonomik “REJ” sh.p.k. nuk ka përmbushur kërkesën e përcaktuar në kriterin e veçantë të kualifikimit 2.3.7, e cila përcakton se:

“Operatori ekonomik ofertues, për solucionet dhe produktet larës dhe dezinfektues të renditura në pikën 3, 4, 5, dhe 6 të Seksionit 2 – Specifikimet teknike të shërbimit të pastrimit, Shtojca 8, duhet të paraqesë: dokumentin me të dhënat e sigurisë (MSDS) të lëshuar nga prodhuesi.”

Në përmbushje të kësaj kërkesë, operatori ekonomik ka paraqitur një autorizim datë 09.10.2025, të lëshuar nga shoqëria “GET klin” sh.p.k., me NIPT: L82420502U, i cili paraqitet në dokument si prodhues i detergjenteve, së bashku me dokumente MSDS për produktet përkatëse.

Nga verifikimi në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), në rubrikën “Leje/Licenca të lëshuara nga QKB”, rezulton se subjekti “GET klin” sh.p.k., NIPT: L82420502U, nuk është i pajisur me Leje/Licencë për Prodhim të Detergjenteve dhe nuk është i pajisur me asnjë lloj Licence tjetër si prodhues apo leje mjedisore si prodhues i Detergjenteve sipas nenit 4 të Ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, si dhe Shtojcën 1 të këtij ligji (ndryshuar me ligjin nr. 52/2020, datë 30.4.2020), ku përcaktohet qartë se: “Për veprimtarinë 4.9 – Prodhimi dhe përpunimi/përzierja e produkteve të pastrimit/ detergjenteve”

Kjo do të thotë se, çdo subjekt që ushtron aktivitet prodhimi ose përpunimi të detergjentëve, duhet të jetë i pajisur me Leje Mjedisore “Për veprimtarinë 4.9 – Prodhimi dhe përpunimi/përzierja e produkteve të pastrimit/ detergjenteve”, të lëshuar nga autoritetet kompetente.

Në mungesë të një Leje që vërteton se kjo shoqëri është prodhues i produkteve detergjente, rezulton se MSDS-të nuk janë të lëshuara nga prodhuesi, siç kërkohet shprehimisht nga dokumentet e tenderit. Për rrjedhojë, KVO vlerëson se operatori ekonomik nuk përmbush kriterin 2.3.7, pasi dokumentet e paraqitura nuk i referohen një prodhuesi të ligjshëm të detergjentëve, duke mos garantuar kështu përmbushjen e specifikimeve teknike dhe kërkesave të sigurisë të parashikuara në tender.

Për sa më sipër, në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, operatori ekonomik “REJ” sh.p.k. skualifikohet nga procedura e prokurimit.

2. Operatori ekonomik “REJ” sh.p.k. ka paraqitur për artikullin nr.3 (“Solucion zbardhues që përdoret për pastrimin dhe dezinfektimin e tualeteve dhe hidrosanitareve”) produktin “Rea Triplex”, të shoqëruar me një Buletin të të Dhënave të Sigurisë (MSDS), të përpiluar nga “Get Klin” sh.p.k.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit teknik dhe MSDS-së së paraqitur, rezulton se operatori nuk përmbush kërkesat e Specifikimeve Teknike për arsyt si vijon:

- Dokumentacioni i paraqitur nuk përmban asnjë referencë që produkti të përdoret specifikisht për pastrimin dhe dezinfektimin e tualeteve dhe hidrosanitareve, siç kërkohet shprehimisht në DST.
- Nuk përmendet se produkti heq pikat e bardha të ujit (lloji i mbetjeve gëlqerore që formohen në sipërfaqe sanitare).
- Nuk jepen udhëzime për raportin e hollimit 1:150–1:200 me ujë, siç kërkohet specifikimi teknik. (Në specifikimin teknik të dokumenteve të tenderit kërkohet që produkti të përdoret edhe për larjen e pllakave të poshtme të tualeteve me hollim 1:150 – 1:200 me ujë. Në MSDS-në e paraqitur nga operatori ekonomik për produktin “Rea Triplex”, nuk jepen udhëzime mbi raportin e hollimit ose mënyrën e përdorimit të produktit në kushte të aplikimit praktik.
- Dokumenti nuk provon se produkti bën pjesë në një linjë profesionale pastrimi, siç kërkohet për produktet e kategorisë sanitare industriale dhe sic specifikohet në nenin 2 “Perkufizime”, pika 12 të Ligjit Nr.10 216, datë 21.1.2010 “Per Detergjentet” në të cilin përcaktohet se: ““Detergjent industrial” është detergjenti i përcaktuar për larje dhe pastrim, të kryer nga personeli i specializuar, që përdor produkte specifike, i papërdorshëm për qëllime shtëpiake.”.

Për sa më sipër, produktin “Rea Triplex” i mungon përputhshmëria e plotë teknike dhe dokumentare me kërkesat e artikullit 3 të Specifikimeve Teknike dhe me kriterin e veçantë të kualifikimit 2.3.7 (MSDS të lëshuar nga prodhuesi).

Si rrjedhojë, operatori ekonomik nuk konsiderohet përmbushës për këtë artikull dhe produkti nuk mund të merret në konsideratë për përmbushjen e kërkesave të kontratës.

3. Operatori ekonomik “REJ” sh.p.k. ka paraqitur, për artikullin nr. 4 (“Solucion për larje pllakash dyshemeje”), produktin “Rea Triplex”, të shoqëruar me një Buletin të të Dhënave të Sigurisë (MSDS), të përpiluar nga “Get Klin” sh.p.k.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit teknik dhe të MSDS-së së paraqitur, rezulton se operatori nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit, të përcaktuar në pikën 2.3.7, në kombinim me Seksionin 2 – Specifikimet teknike të shërbimit të pastrimit të brendshëm dhe të jashtëm, Shtojca 8 “Specifikimet teknike”, që lidhen me solucionet e renditura në pikat 3, 4, 5 dhe 6 “Solucionet dhe produktet larës dhe dezinfektues”, për arsyt si më poshtë:

Sipas specifikimeve teknike, për artikullin Nr.4, kërkohet: “Solucion për larje pllakash dyshemeje. Të jetë sa më i koncentruar (1:200 me ujë). Të lërë aromë të lehtë pas larjes. Të jetë prodhim me standarde të BE-së dhe i certifikuar sipas këtyre standardeve. Të ketë kartat e sigurisë dhe përbërjes. Masa nga 1 deri në 10 litra. Të jetë linjë profesionale. Niveli i pH (8 +/- 5%).”

Operatori ekonomik i referuar më sipër ka paraqitur MSDS për produktin “Solo Pavimenti 1L”, i cili, sipas dokumentit, është zbardhues dhe dezinfektues. Nga analiza rezulton se ky produkt nuk përmbush specifikimet teknike të publikuara në DST për këtë produkt, pasi:

- Nuk jep udhëzime për hollim 1:200 me ujë, siç kërkohet specifikimi teknik;
- Nuk jep asnjë informacion që vërteton se produkti është pjesë e një “linje profesionale”, siç kërkohet në DST dhe sic specifikohet në nenin 2 “Perkufizime”, pika 12 të Ligjit Nr.10 216, datë 21.1.2010 “Per Detergjentet” në të cilin përcaktohet se: ““Detergjent industrial” është detergjenti i përcaktuar për larje dhe

pastrim, të kryer nga personeli i specializuar, që përdor produkte specifike, i papërdorshëm për qëllime shtëpiake.”. Në dokument nuk identifikohet asnjë referencë ndaj përdorimit industrial ose profesional,

- Mungojnë të dhënat për certifikimet ose standardet e aplikueshme (p.sh. EN, ISO, ose CE), që të konfirmonin klasifikimin e produktit sipas standardeve të Bashkimit Evropian.

4. Operatori ekonomik “REJ” sh.p.k. ka paraqitur për artikullin nr. 5 (“Solucion për larje xhamash”) produktin “Rea Cristal”, të shoqëruar me një Buletin të të Dhënave të Sigurisë (MSDS) të përpiluar nga “Get Klin” sh.p.k.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit teknik dhe të MSDS-së së paraqitur, rezulton se operatori nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit, të përcaktuar në pikën 2.3.7, në kombinim me Seksionin 2 – Specifikimet teknike të shërbimit të pastrimit të brendshëm dhe të jashtëm, Shtojca 8 “Specifikimet teknike”, për arsytet si më poshtë:

Sipas pikës 5 të specifikimeve teknike, kërkohet:

“Solucion për larje xhamash (me spray). Të jetë prodhim me standarde të BE-së dhe i certifikuar. Të ketë kartat e sigurisë dhe përbërjes. Të ketë aromë të lehtë. Masa të jetë 500–800 ml me spray. Të jetë linjë profesionale. Niveli i pH (8.5–9).”

Nga shqyrtimi i MSDS-së së produktit “Rea Cristal” rezulton se:

- Megjithatë, MSDS nuk përmban asnjë informacion për masën, paketimin apo ekzistencën e mekanizmit “spray” (500–800 ml), që është kërkesë eksplicite e DST-së;
- Dokumenti është përpiluar nga një subjekt vendas dhe nuk vërteton se produkti është “prodhim me standarde të BE-së”, siç kërkohet në DST;
- Në MSDS nuk specifikohet klasifikimi profesional i produktit (“përdorim profesional”), çka nuk lejon verifikimin nëse produkti i përket “linjës profesionale” të kërkuar dhe sic specifikohet në nenin 2 “Perkufizime”, pika 12 te Ligjit Nr.10 216, datë 21.1.2010 “Per Detergjentet” në të cilin përcaktohet se: ““Detergjent industrial” është detergjenti i përcaktuar për larje dhe pastrim, të kryer nga personeli i specializuar, që përdor produkte specifike, i papërdorshëm për qëllime shtëpiake.”;

Për rrjedhojë, operatori ekonomik skualifikohet pasi nuk përmbushë kriteret e kualifikimit.

5. Operatori ekonomik “REJ” sh.p.k. ka paraqitur për artikullin nr. 6 (“Solucion për larje mobiljesh”) produktin “Ana Mobilje”, të shoqëruar me një Buletin të të Dhënave të Sigurisë (MSDS), të përpiluar nga “Get Klin” sh.p.k.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit teknik dhe të MSDS-së së paraqitur, rezulton se operatori nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit, të përcaktuar në pikën 2.3.7, në kombinim me Seksionin 2 – Specifikimet teknike të shërbimit të pastrimit të brendshëm dhe të jashtëm, Shtojca 8 “Specifikimet teknike”, që lidhen me solucionet e renditura në pikat 3, 4, 5 dhe 6 “Solucionet dhe produktet larës dhe dezinfektues”, për arsytet si më poshtë:

Sipas pikës 6 të specifikimeve teknike, kërkohet:

“Solucion për larje mobiljesh (me spray) 500 ml. Të jetë prodhim me standarde të BE-së dhe i certifikuar. Të ketë kartat e sigurisë dhe përbërjes. Të ketë aromë të lehtë. Të jetë linjë profesionale. Niveli i pH (8–

9).”

Nga analiza e MSDS-së së produktit “Ana Mobilje” rezulton se:

- Dokumenti nuk përmban asnjë informacion mbi origjinën ose certifikimin e produktit, dhe nuk provon se është “prodhim me standarde të BE-së” apo i certifikuar sipas ndonjë standardi të miratuar nga BE;
- MSDS-ja nuk përcakton qartë nëse produkti është “linjë profesionale”, pra nëse është i destinuar për përdorim profesional apo konsumator, siç kërkohet në DST dhe sic specifikohet në nenin 2 “Perkufizime”, pika 12 të Ligjit Nr.10 216, datë 21.1.2010 “Për Detergjentet” në të cilin përcaktohet se: ““Detergjent industrial” është detergjenti i përcaktuar për larje dhe pastrim, të kryer nga personeli i specializuar, që përdor produkte specifike, i papërdorshëm për qëllime shtëpiake.”;

Persa me sipër, operatori ekonomik skualifikohet.

6. Operatori ekonomik “REJ” Sh.p.k, nuk ka paraqitur autorizimin nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për lëndët biocide që do të përdoren gjatë kryerjes së shërbimit. Sipas pikës 2.3.8 të specifikimeve teknike, çdo ofrues që përdor lëndë biocide duhet të vërtetojë lidhjen me prodhuesin ose distributorin e autorizuar dhe të sigurojë të dhënat e plota të kontaktit për verifikim nga Autoriteti Kontraktor. Sipas analizës së specifikimeve teknike, përdorimi i lëndëve biocide është i paevitueshëm, sepse shërbimi objekt prokurimi kërkon dezinfektim dhe kontroll të mikroorganizmave patogjenë si psh në Sallat e Operacionit, në Ambjentet e Kujdesit Intesiv dhe në ambjentet e tjera Spitalore që janë me risk shumë të lartë infektimi, për të garantuar standardet e sigurisë dhe higjienës të përcaktuara. Pa përdorimin e biocidëve të autorizuar, nuk mund të arrihet niveli i kërkuar i pastrimit dhe mbrojtjes, çka e bën të pamundur përmbushjen e kushteve teknike të kontratës.

Për shkak të mungesës së dokumentacionit të autorizimit përkatës, oferta skualifikohet.

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. Operatori ekonomik “Pastrime Silvio” me Nuis K91413010N

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Arsyet e skualifikimit:

1. Operatori ekonomik “Pastrime Silvio” sh.p.k, nuk ka përmbushur kriterin e veçantë të kualifikimit, pika 1, shkronja a), pasi në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit, Seksioni D – “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”, nuk ka specifikuar dokumentin apo adresën konkrete ku autoriteti kontraktor mund të verifikojë deklaratimet e mëposhtme:
 - Garantimin e mbrojtjes së të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, sipas legjislacionit në fuqi;
 - Lidhjen e kontratave të punës dhe garantimin e masave të sigurisë e shëndetit në punë, veçanërisht për grupet e rrezikuara;

• Mungesën e masave ligjore në fuqi të vendosura nga ISHPSHSH, apo adresimin e tyre brenda afateve në rast shkeljesh të konstatuara.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Mungesa e informacionit për verifikim e bën të pamundur vërtetimin e deklarimeve dhe përbën shkak për skualifikim nga procedura.

KVO konstaton që operatori ekonomik nuk ka paraqitur të dhëna, dokumenta referues dhe/ose adresat për plotësimin e të gjitha rubrikave të mësipërme. Qendrim ky i mbajtur dhe nga Komisioni i Prokurimeve Publike me ane të vendimit Nr.209/2025, datë 07.02.2025, i cili ka theksuar se: “Formulari Permbledhes i Vetedeklarimit duhet të plotësohet në të gjithë seksionet e saj duke dhënë deklaruar adresën apo dokumentin konkret mbi bazën e të ciles/cilit autoriteti mund të bëjë verifikimin e vetdeklarimeve dhe mosplotësimi i tij në të gjithë seksionet përkatëse përben kusht skualifikimi”.

Te njëjtin qendrim KPP ka mbajtur edhe me Vendimet Nr.816/2025, datë 27.06.2025 dhe Nr.1264/2025, datë 17.09.2025. Për sa me sipër operatori ekonomik skualifikohet.

2. Operatorit ekonomik “Pastrime Silvio” sh.p.k. nuk ka përmbushur kërkesën e përcaktuar në kriterin e veçantë të kualifikimit 2.3.7, i cili përcakton se: “Operatori ekonomik ofertues, për solucionet dhe produktet larëse dhe dezinfektuese të renditura në pikën 3, 4, 5 dhe 6 të Seksionit 2 – Specifikimet teknike të shërbimit të pastrimit, Shtojca 8, duhet të paraqesë dokumentin me të dhënat e sigurisë (MSDS), të lëshuar nga prodhuesi.”

Në përmbushje të kësaj kërkesë, operatori ekonomik ka paraqitur një autorizim të datës 20.10.2025, të lëshuar nga shoqëria “ARSEL – DETERGJENT” sh.p.k., e cila në dokument paraqitet si prodhues i detergjentëve, së bashku me dokumentet MSDS përkatëse për produktet e ofruara.

Nga verifikimi i kryer në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), në rubrikën “Leje/Licenca të lëshuara nga QKB”, rezulton se subjekti “ARSEL – DETERGJENT” sh.p.k., me NIPT L01605513C, është i pajisur vetëm me Leje Mjedisore të tipit C (Licenca PN-7447-10-2018), me objekt aktiviteti:

“Magazinimi i kimikateve.”- i perket veprimtarinë 4.7

Ndërkohë, në përputhje me nenin 4 të Ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, si dhe Shtojcën 1 të këtij ligji (ndryshuar me ligjin nr. 52/2020, datë 30.4.2020), përcaktohet qartë se: “Për veprimtarinë 4.9 – Prodhimi dhe përpunimi/përzierja e produkteve të pastrimit/detergjenteve”

Kjo do të thotë se, çdo subjekt që ushtron aktivitet prodhimi ose përpunimi të detergjentëve, duhet të jetë i pajisur me Leje Mjedisore “Për veprimtarinë 4.9 – Prodhimi dhe përpunimi/përzierja e produkteve të pastrimit/ detergjenteve”, të lëshuar nga autoritetet kompetente.

Për rrjedhojë, subjekti “ARSEL – DETERGJENT” sh.p.k., i cili zotëron vetëm Leje Mjedisore të tipit C për magazinim kimikatesh, nuk përmbush kërkesat ligjore për të ushtruar aktivitetin e prodhimit apo përpunimit/përzierjes së detergjentëve, dhe për pasojë nuk mund të konsiderohet prodhues i ligjshëm i këtyre produkteve.

Gjithashtu, në pikën 4.1.4 të Lejes Mjedisore të Tipit C, të lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit – Drejtoria Rajonale e Mjedisit, Qarku Durrës, përcaktohet se: “Kjo leje është e vlefshme vetëm për deklaratimet që subjekti bën në formularin e kërkesës për Leje Mjedisi.”

Kjo vërtetohet se subjekti nuk zotëron leje për veprimtari prodhimi, por vetëm për magazinim kimikatesh. Në mungesë të një Leje Mjedisore “Për veprimtarinë 4.9 – Prodhimi dhe përpunimi/përzjerja e produkteve të pastrimit/ detergjenteve”, kjo shoqëri nuk ushtron ligjërisht aktivitetin e prodhimit të detergjenteve, MSDS-të e paraqitura nuk mund të konsiderohen të lëshuara nga prodhuesi, siç kërkohet shprehimisht në dokumentet e tenderit.

Në bazë të sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) vlerëson se operatori ekonomik “Pastrime Silvio” sh.p.k. nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit 2.3.7, pasi dokumentet e paraqitura nuk i referohen një prodhuesi të ligjshëm të produkteve detergjente, dhe për pasojë operatori skualifikohet.

3. Operator ekonomik “Pastrime Silvio” sh.p.k, ka paraqitur për artikullin nr. 3 (“Solucion zbardhues që përdoret për pastrimin dhe dezinfektimin e tualeteve dhe hidrosanitareve”) produktin “MAX ACE”, të shoqëruar me një Buletin të të Dhënave të Sigurisë (MSDS) të lëshuar nga “ARSEL DETERGJENT sh.p.k.”.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit teknik dhe të MSDS-së së paraqitur, rezulton se operatori nuk përmbush kërkesat e pikës 3 të Specifikimeve Teknike, për arsyet si më poshtë:

- Edhe pse në MSDS është përmendur se produkti ka përmbajtje klori dhe pH 1.5 ± 0.2 , dokumentacioni nuk specifikon përdorimin e produktit për pastrimin dhe dezinfektimin e tualeteve dhe hidrosanitareve, siç kërkohet shprehimisht në DST, dhe nuk deklaron se heq pikat e bardha të ujit (mbetjet gëlqerore karakteristike të sipërfaqeve sanitare).
- Dokumenti nuk provon se produkti bën pjesë në linjë profesionale pastrimi, siç kërkohet për produktet sanitare industriale dhe sic specifikohet në nenin 2 “Perkufizime”, pika 12 të Ligjit Nr.10 216, datë 21.1.2010 “Per Detergjentet” në të cilin përcaktohet se: ““Detergjent industrial” është detergjenti i përcaktuar për larje dhe pastrim, të kryer nga personeli i specializuar, që përdor produkte specifike, i papërdorshëm për qëllime shtëpiake.”.
- MSDS-ja nuk jep referenca për testime laboratorike ose certifikime të standardeve të BE-së, që lidhen me produktet profesionale (metodat e testimit të referuara në pikën 3, të nenit 12, të ligjit nr. 27/2016, “Për menaxhimin e kimikateve”).

Si rrjedhojë, operatori ekonomik nuk konsiderohet se përmbush kriterin e kualifikimit dhe kërkesat e DST.

4. Operator ekonomik “Pastrime Silvio” sh.p.k, ka paraqitur për artikullin nr.4 (“Solucion për larje pllakash dyshemeje”) produktin “MAX CASA”, të shoqëruar me një Buletin të të Dhënave të Sigurisë (MSDS) të lëshuar nga “ARSEL DETERGJENT” sh.p.k.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit teknik dhe të MSDS-së së paraqitur, rezulton se operatori nuk përmbush kërkesat e pikës 4 të Specifikimeve Teknike, për arsyet si më poshtë:

- Në dokumentacionin teknik nuk provohet se produkti “Max Casa” është i destinuar për larjen e pllakave të dyshemeve, sipas përdorimit specifik të kërkuar në DST. Dokumenti jep përshkrim të përgjithshëm si “produkt i lëngshëm me aromë freskie”, por pa referencë të drejtpërdrejtë për përdorim në sipërfaqe dyshemeje.
- Gjithashtu, nuk provohet se produkti bën pjesë në një linjë profesionale për pastrimin industrial, siç kërkohet në DST dhe sic specifikohet në nenin 2 “Perkufizime”, pika 12 të Ligjit Nr.10 216, datë 21.1.2010 “Per Detergjentet” në të cilin përcaktohet se: ““Detergjent industrial” është detergjenti i përcaktuar për larje dhe pastrim, të kryer nga personeli i specializuar, që përdor produkte specifike, i papërdorshëm për qëllime shtëpiake.”.
- Dokumenti është përpiluar nga subjekti prodhues vendas “Arsel Detergjent sh.p.k.”, por nuk jep asnjë

referencë për certifikim të standardeve të BE-së apo testime të pavarura sipas standarteve të BE ose ekuivalente, që janë tipike për produktet profesionale të pastrimit.

Si rrjedhojë, operatori ekonomik nuk konsiderohet përmbushës kriterin e kualifikimit dhe specifikimet teknike.

5. Operator ekonomik “Pastrime Silvio” sh.p.k, ka paraqitur për artikullin nr.5: “Solucion për larje xhamash (me spray)” – produkti “Xhamsil”, prodhues: ARSEL DETERGJENT sh.p.k. (MSDS “Xhamsil”) Pas shqyrtimit të dokumentacionit teknik dhe MSDS-së të paraqitur, rezulton se operatori nuk përmbush plotësisht kërkesat e pikës 5 të Specifikimeve Teknike (“Të jetë prodhim me standarde të BE dhe i certifikuar...; 500–800 ml me spray; linjë profesionale; pH 8.5–9; karta sigurie dhe përbërjeje”), për këto arsye:

- “Linjë profesionale”: Nuk ka asnjë provë/deklaratë që produkti i përket linjës profesionale (referencë prodhuesi, katalog profesional, certifikim përdorimi profesional, etj.) dhe sic specifikohet në nenin 2 “Perkufizime”, pika 12 të Ligjit Nr.10 216, datë 21.1.2010 “Per Detergjentet” në të cilin përcaktohet se: ““Detergjent industrial” është detergjenti i përcaktuar për larje dhe pastrim, të kryer nga personeli i specializuar, që përdor produkte specifike, i papërdorshëm për qëllime shtëpiake.”.

Si përfundim, operatori ekonomik nuk konsiderohet se përmbush kriterin e kualifikimit dhe specifikimet teknike për këtë arsye skualifikohet.

6. Operator ekonomik “Pastrime Silvio” sh.p.k, ka paraqitur për artikullin nr.6: “Solucion Mobiljesh (me spray)” – produkti “Solucion Mobiljesh”, prodhues: ARSEL DETERGJENT sh.p.k. (MSDS “Solucion Mobiljesh”)

Pas shqyrtimit të dokumentacionit teknik dhe MSDS-së të paraqitur, rezulton se operatori nuk përmbush plotësisht kërkesat e pikës 6 të Specifikimeve Teknike (“Të jetë prodhim me standarde të BE dhe i certifikuar...; 500 ml me spray; linjë profesionale; pH 8–9; karta sigurie dhe përbërjeje”), për këto arsye: Operator ekonomik “Pastrime Silvio” sh.p.k, ka paraqitur për artikullin nr. 6: “Solucion për larje mobiljesh (me spray)” – produkti “Solucion Mobiljesh”, prodhues: ARSEL DETERGJENT sh.p.k. (MSDS “Solucion Mobiljesh”)

Pas shqyrtimit të dokumentacionit teknik dhe MSDS-së të paraqitur, rezulton se operatori nuk përmbush plotësisht kërkesat e pikës 6 të Specifikimeve Teknike:

- Përdorimi dhe linja profesionale – dokumenti nuk përmban asnjë referencë që produkti është pjesë e një linje profesionale të pastrimit (p.sh. mungojnë katalogë, etiketa profesionale ose certifikata përdorimi profesional) dhe sic specifikohet në nenin 2 “Perkufizime”, pika 12 të Ligjit Nr.10 216, datë 21.1.2010 “Per Detergjentet” në të cilin përcaktohet se: ““Detergjent industrial” është detergjenti i përcaktuar për larje dhe pastrim, të kryer nga personeli i specializuar, që përdor produkte specifike, i papërdorshëm për qëllime shtëpiake.”.

Operatori ekonomik nuk konsiderohet se përmbush kriterin e kualifikimit dhe specifikimet teknike, për këtë arsye skualifikohet.

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepet dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. Operatori ekonomik “CLEAN FAST”

Emri i plotë i shoqërisë

me Nuis L61807037R

Numri i NIPT-it

Arsyet e skualifikimit:

Sipas Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik (KPP) nr. 104/2026, datë 20.01.2026

1. Sigurimi i ofertës i paraqitur nga operatori ekonomik “Clean Fast” sh.p.k., edhe pse në vlerë të saktë, nuk përmbush kriterin 1, shkronja b), pasi afati 150-ditor nuk fillon nga data e mbylles së tenderit (20.10.2025) por fillon nga data 16.10.2025 deri më 15.03.2026, kur sipas kërkesës duhej të përfshinte periudhën 20.10.2025 – 18.03.2026 (150 dite). Ndryshe nga rasti i trajtuar nga Komisioni i Prokurimeve Publike me Vendimin Nr.1459/2025, datë 16.10.2025, ku sigurimi i ofertës i operatorit Mine Lloshi P.F. ishte lëshuar përpara datës së hapjes së tenderit, por specifikonte se (sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në (njoftimin e kontratës ose ftesën për tender) 150 ditë), në rastin aktual periudha e sigurimit të ofertës nga “Clean Fast” nuk mbulon plotësisht afatin e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Për këtë arsye, operatori “Clean Fast” sh.p.k. skualifikohet, duke u bazuar në kriterin specifik të dokumenteve të tenderit që kërkon mbulimin e të gjithë periudhës së 150 ditëve nga data e dorëzimit të ofertave.

2. Operatori ekonomik “Clean Fast” sh.p.k. ka ofruar një solucion pastrimi për mobilie, i cili, sipas të dhënave teknike të paraqitura në katalog, përdoret vetëm për sipërfaqe rezistente ndaj ujit. Ndërkohë, kërkesa teknike e përcaktuar në dokumentet e tenderit parashikon solucion pastrimi të përgjithshëm për mobilie, pa kufizim në llojin e materialit mbi të cilin përdoret. Për rrjedhojë, produkti i ofruar nuk përputhet plotësisht me specifikimet teknike, dhe si i tillë, operatori ekonomik nuk konsiderohet plotësisht përmbushës për këtë artikull. Gjithashtu, autorizimi i datës 13.10.2025, i lëshuar nga prodhuesi “Johannes Kiehl KG” në favor të distributorit në Shqipëri “Globi” sh.p.k., është paraqitur në formë fotokopie, pa u shoqëruar me origjinalin ose me kopje të noterizuar.

Për pasojë, duke qenë se autorizimi i paraqitur nuk është origjinal apo i noterizuar dhe produktit i mungon përputhshmëria e plotë me kërkesat teknike, fleta e sigurisë së materialit (MSDS) e paraqitur për solucionin larës të mobilieve nuk mund të merret në konsideratë për përmbushjen e kriterit të veçantë të kualifikimit, sipas pikës 2.3.7 të dokumenteve të tenderit.

3. Operatori ekonomik “Clean Fast” sh.p.k. nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit, pikën 2.3.8 ne kombinim me 2.3.7, pasi Autorizimi i lëshuar nga distributori nuk është i vlefshëm për arsyet në vijim:

1. Analiza e datave dhe dokumenteve

a) Autorizimi i lëshuar nga prodhuesi (Johannes Kiehl KG) për distributorin Globi SHPK mban datën 13.10.2025, nepermjet të cilit konfirmohet Globi SHPK është përfaqësuesi i vetëm zyrtar për produktet “Kiehl” në Shqipëri. Kjo Certificate hyn në fuqi nga data e lëshimit dhe është e vlefshme “deri në revokim”.

Nderkohe, Autorizimi i lëshuar nga distributori (Globi SHPK) për shoqerine “Clean Fast” Sh.p.k mban datën 01.10.2025, nepermjet të cilit Globi SHPK autorizon Clean Fast SHPK të përdorë produktet “Kiehl Group” dhe dokumentacionin teknik për një procedurë të caktuar prokurimi.

Autorizimi i lëshuar nga Globi SHPK mban datë 01.10.2025, ndërsa certifikata që e legjitimon Globin si përfaqësues zyrtar i markës “Kiehl” është 13.10.2025, pra 12 ditë më vonë. Kjo do të thotë se në momentin e lëshimit të autorizimit për Clean Fast SHPK (më 1 tetor), Globi SHPK nuk kishte ende statusin e konfirmuar zyrtarisht nga prodhuesi Kiehl për të qenë përfaqësues ekskluziv në territorin e Shqipërisë.

Në momentin e lëshimit të autorizimit të datës 01.10.2025, kompania Globi SHPK nuk kishte ende një certifikim të vlefshëm nga prodhuesi Johannes Kiehl KG që e autorizon të përfaqësojë markën “Kiehl” në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Certifikata nga prodhuesi mban datë 13.10.2025, pra pas datës së lëshimit të autorizimit ndaj Clean Fast SHPK, çka do të thotë se në kohën e nënshkrimit të autorizimit Globi SHPK nuk kishte kapacitetin juridik për të transferuar të drejta përdorimi, përfaqësimi apo dokumentacioni teknik në emër të Kiehl Group.

Për pasojë, autorizimi i datës 01.10.2025 rezulton i pavlefshëm, pasi është lëshuar:

- pa bazë ligjore dhe pa mandat aktiv nga prodhuesi;
- në kundërshtim me parimin e vlefshmërisë kohore të autorizimeve të deleguara.

Në kuptim të praktikës së prokurimit publik, kjo përbën mospërbushje të kërkesës për dokumentacion të vlefshëm për përfaqësim nga prodhuesi, pasi dokumenti i paraqitur (autorizimi nga distributori) nuk mbështetet në një autorizim të vlefshëm në datën e nënshkrimit të tij.

Për rrjedhojë, operatori ekonomik skualifikohet.

4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), operatori ekonomik “Clean Fast” sh.p.k. ka dorëzuar:

- Autorizim datë 13.10.2025, lëshuar nga prodhuesi “Johannies Kiehl KG” për distributorin në Shqipëri, shoqërinë “Globi” sh.p.k., në gjuhën angleze;
- Përkthim në gjuhën shqipe nga përkthyesja e licencuar Edlira Hysa. Gjatë shqyrtimit të dokumenteve, KVO ka konstatuar se:
- Dokumenti i autorizimit është fotokopje, pra jo origjinal dhe jo kopje e noterizuar;
- Nuk është paraqitur asnjë akt noterial që të vërtetojë njëhësimin e dokumentit të dorëzuar me origjinalin.

Në këto kushte, autorizimi nuk mund të konsiderohet dokument i vlefshëm, pasi nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në DST dhe në Manualin e APP-së.

Referuar kërkesave të DST-së, ku parashikohet se të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara, Manualit nr.1 Datë 24.12.2018 “Për Regjistrimin Operatorëve Ekonomikë dhe dorëzimin e ofertave në sistemin e prokurimit elektronik., ku në faqen 17 të këtij manuali përcaktohet se Dokumentat e skanuara duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara dhe mosplotësimi i ketyre detyrimeve, përbën mospërbushje të kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe arsye për skualifikim.

Në përfundim të shqyrtimit, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) gjykon se Operatori ekonomik “Clean Fast” sh.p.k., me dokumentacionin e dorëzuar, nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.8 të DST-së, pasi autorizimi i paraqitur nuk është origjinal apo kopje e noterizuar.

Në përputhje me sa më sipër, KVO vendos skualifikimin e operatorit ekonomik “Clean Fast” sh.p.k. nga procedura e prokurimit.

4. Bashkimi i Operatorëve ekonomik:

Operatori ekonomik “NRG” me Nuis L13426006B

Operatori ekonomik E.P.M. S.R.L & me NUIS 04731170637

Operatori ekonomik “Alben Pulito” Sh.p.k NUIS K61516506H

Arsyet e skualifikimit:

1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “NRG” sh.p.k, E.P.M. S.R.L (Itali) dhe “Alben Pulito” sh.p.k nuk ka përmbushur kërkesat ligjore dhe teknike për krijimin dhe regjistrimin e bashkimit në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), sipas Manualit të Agjencisë së Prokurimit Publik (APP), Nr. 01, datë 26.01.2018, “Për regjistrimin e operatorëve ekonomikë dhe dorëzimin e ofertave në Sistemin e Prokurimit Elektronik”.

Sipas Manualit Nr.01, datë 26.01.2018 “Për regjistrimin e operatorëve ekonomikë dhe dorëzimin e ofertave në Sistemin e Prokurimit Elektronik”, në kreun “3. Dorëzimi i ofertës në procedurat pa lote”, përcaktohet qartë se:

“Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, kryesuesi duhet të kërkojë në Sistemin e Prokurimit Elektronik operatorët ekonomikë me të cilët është bashkuar, duke klikuar opsionin ‘Look up’ në hapësirën ‘Bashkimi i operatorëve ekonomikë’. (...)”

Kur të keni përfunduar me përcaktimin e të gjithë operatorëve ekonomikë që përbëjnë bashkimin tuaj, klikoni butonin ‘Dakort’ dhe më pas duhet të vazhdoni me hedhjen e dokumentave të këtij bashkimi operatorësh duke klikuar butonin ‘Hapi Tjetër’.

Kujdes: Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, veprimet e përshkuara më sipër bëhen nga llogaria e kryesuesit të bashkimit të operatorëve ekonomikë.”

Nga kjo dispozitë, rezulton se:

- Regjistrimi paraprak në SPE i çdo operatori që është pjesë e bashkimit është kusht i domosdoshëm për krijimin e BOE-së;
- Pa u regjistruar të gjithë operatorët, sistemi nuk lejon as përfundimin e hapit “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”;
- Kjo përbën pengesë ligjore dhe teknike për një ofertë të vlefshme në kuptim të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Në sistemin e APP-së, në rubrikën “Është Bashkim Operatorësh Ekonomikë”, pas përzgjedhjes së opsionit “PO”, sistemi kërkon shtimin e çdo operatori që bën pjesë në bashkim, duke e kërkuar atë me emër ose NUIS, dhe më pas duke përcaktuar përqindjen përkatëse të pjesëmarrjes deri në plotësimin e 100% të vlerës totale të bashkimit.

Në këtë rast, u identifikuan dhe u shtuan me sukses në sistem dy operatorët shqiptarë, përkatësisht:

- “NRG” sh.p.k me pjesëmarrje 15%;

- “Alben Pulito” sh.p.k me pjesëmarrje 30%.

Ndërkohë, për operatorin e huaj E.P.M. S.R.L (me seli në Itali), nuk ishte e mundur të kryhej kërkimi dhe shtimi në sistem, pasi operatori nuk rezultoi i regjistruar në SPE, as përmes kërkimit me emër dhe as me numër identifikimi fiskal (NUIS).

Për shkak të kësaj mungese, sistemi nuk e lejon përfundimin e procesit të krijimit të BOE-së, duke kërkuar që përqindja totale e bashkimit të jetë 100% përpara vijimit të hapave të tjerë.

Në mungesë të operatorit të huaj, përqindja e përgjithshme mund të plotësohet vetëm në 45%, dhe rrjedhimisht nuk mund të vijoheshin hapat e tjerë të krijimit të bashkimit apo dorëzimit të ofertës së përbashkët.

Ky fakt përbën pamundësi teknike dhe ligjore për krijimin e bashkimit në sistem dhe tregon se operatori i huaj E.P.M. S.R.L nuk ka përmbushur detyrimin e regjistrimit në përputhje me Manualin e APP Nr.01, datë 26.01.2018 “Për regjistrimin e operatorëve ekonomikë dhe dorëzimin e ofertave në Sistemin e Prokurimit Elektronik”, i cili përcakton:

“Operatorët ekonomikë të huaj, për të përdorur Sistemin e Prokurimit Elektronik, duhet të regjistrohen dhe të pajisen me një llogari përdoruesi. Kjo mund të realizohet me anë të një kërkesë zyrtare pranë zyrave të APP ose duke u regjistruar online si operator ekonomik.”

Mosregjistrimi i operatorit të huaj sjell mospërmbushje të kërkesave të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, pasi bashkimi i operatorëve ekonomikë duhet të jetë i formalizuar dhe i regjistruar si subjekt unik në sistemin elektronik përpara dorëzimit të ofertës.

Për shkak të kësaj pamundësie teknike të sistemit, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO), gjatë krijimit të procedurës në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), është detyruar të përzgjedhë opsionin “JO” në rubrikën “Është Bashkim Operatorësh Ekonomikë”, me qëllim që të mund të vijojë me hapat e tjerë të procesit të vlerësimit dhe administrimit të procedurës në sistem.

Ky veprim është kryer vetëm për arsye teknike, pasi sistemi nuk lejon vijimin e procedurës në rastet kur bashkimi nuk plotëson 100% të përqindjeve të pjesëmarrësve.

Ky veprim nuk përbën në asnjë rast konfirmim të vlefshmërisë së bashkimit të operatorëve ekonomikë, por është ndërmarrë për të garantuar funksionimin e procesit teknik në SPE.

Ky fakt është konstatuar dhe pasqyruar qartë në Procesverbalin fizik të Vlerësimit të Ofertave, i cili është nënshkruar nga të tre anëtarët e KVO-së, dhe shërben si provë dokumentare e veprimeve të kryera në sistem.

Si përfundim, në këto rrethana, B.O.E. “NRG” sh.p.k, E.P.M. S.R.L dhe “Alben Pulito” sh.p.k nuk përmbush kërkesat ligjore dhe teknike për krijimin e bashkimit në SPE.

Mosregjistrimi i operatorit të huaj bën të pamundur përfundimin e procesit të bashkimit dhe dorëzimin e vlefshëm të ofertës së përbashkët, prandaj, në përputhje me ligjin nr.162/2020 dhe Manualin e APP nr.01, datë 26.01.2018, operatorët ekonomikë në fjalë skualifikohen nga procedura e prokurimit.

2. Operatori ekonomik “E.P.M.” S.R.L., nuk ka përmbushur kriterin e veçantë të kualifikimit, pika 1, shkronja a), pasi në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit, Seksioni D – “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”, nuk ka specifikuar dokumentin apo adresën konkrete ku autoriteti kontraktor mund të verifikojë deklaratimet e mëposhtme:

- Garantimin e mbrojtjes së të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- Lidhjen e kontratave të punës dhe garantimin e masave të sigurisë e shëndetit në punë, veçanërisht për grupet e rrezikuara;
- Mungesën e masave ligjore në fuqi të vendosura nga ISHPSHSH, apo adresimin e tyre brenda afateve në rast shkeljesh të konstatuara.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Mungesa e informacionit për verifikim e bën të pamundur vërtetimin e deklarimeve dhe përbën shkak për skualifikim nga procedura.

KVO konstaton qe operatori ekonomik nuk ka paraqitur të dhëna, dokumenta referues dhe/ose adresat për plotësimin e të gjitha rubrikave të mësipërme. Qendrim ky i mbajtur dhe nga Komisioni i Prokurimeve Publike me ane te vendimit Nr.209/2025, date 07.02.2025, i cili ka theksuar se: “Formulari Përmbledhës i Vetedeklarimit duhet te plotesohet ne te gjithe seksionet e saj duke dhene deklaruar adresen apo dokumentin konkret mbi bazen e te ciles/cilit autoriteti mund te beje verifikimin e vetdeklarimeve dhe mosplotesimi i tij ne te gjithe seksionet perkatese perben kusht skualifikimi”.

Te njejtin qendrim KPP ka mbajtur edhe me Vendimet Nr.816/2025, date 27.06.2025 dhe Nr.1264/2025, date 17.09.2025. Per sa me siper operatori ekonomik skualifikohet.

3. Operatori ekonomik “E.P.M.” S.R.L., nuk ka nënshkruar dhe as vulosur Shtojcën nr.12, “Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit”, duke mos marrë përsipër detyrimet dhe kapacitetet e parashikuara në këtë formular. Në mungesë të nënshkrimit dhe vulës, dokumenti nuk përmban shprehje të vlefshme të vullnetit juridik të operatorit ekonomik dhe, për pasojë, nuk prodhon asnjë efekt apo pasojë ligjore ndaj tij. Në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, një dokument i pa nënshkruar nuk vërtetohet pranimin apo angazhimin e subjektit dhe konsiderohet i pavlefshëm për qëllime juridike.

4. Operatori ekonomik “E.P.M.” S.R.L. nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit, pikën 2.2.1 të Dokumenteve të Tenderit, pasi nuk ka paraqitur vërtetim zyrtar për xhiron vjetore të viteve 2022, 2023 dhe 2024, të lëshuar nga një autoritet publik ose subjekt privat i njohur/licensuar nga legjislacioni italian për këtë qëllim.

Operatori ka dorëzuar një dokument të titulluar “Vërtetim për qarkullimin vjetor”, i nënshkruar nga z. Sergio Rizzo, por pa asnjë dokument shoqërues që të provojë kompetencën ligjore, statusin profesional ose autorizimin e personit në fjalë për të lëshuar dokumente të këtij karakteri në përputhje me ligjin Italian. Në mungesë të një vërtetimi të lëshuar nga autoritete zyrtare (të tilla si Zyra Tatimore, Dhoma e Tregtisë, ose një kontabilist i regjistruar në regjistrat profesionale të Italisë), dokumenti i paraqitur nuk mund të pranohet si dëshmi e vlefshme për përmbushjen e këtij kriteri të veçantë të kualifikimit. Për këto arsye, operatori ekonomik “E.P.M.” S.R.L. konsiderohet si i pa kualifikuar për kriterin 2.2.1, në mungesë të dokumentacionit të vlefshëm dhe të verifikueshëm sipas kërkesave të Dokumenteve të Tenderit dhe legjislacionit në fuqi për prokurimin publik.

5. Operatori ekonomik “E.P.M.” S.R.L. nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit, të parashikuar në pikën 2.2.1, pasi nuk ka paraqitur Bilancet Zyrtare për vitet 2022, 2023 dhe 2024. Ai ka paraqitur vetëm

disa përkthime të kryera me Google Translate, të cilat nuk janë shoqëruar me Bilancet orgjinale 2022-2023-2024 dhe as me me përkthime të vlefshme nga një përkthyes zyrtare anglishtfolëse dhe jo nga google translate. Theksojmë se gjuha zyrtare e procedurës është sipas Dokumenteve të Tenderit (DST) ose në shqip, ose në anglisht, dhe përkthimet e paraqitura nga operatori “E.P.M.” S.R.L., të kryera përmes Google Translate dhe pa shoqërim nga përkthyes zyrtar anglishtfolës, nuk përmbushin këtë kërkesë zyrtare.

6. Sipas pikës 2.3.1 të Dokumenteve të Tenderit, operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39% e fondit limit të marrëveshjes kuadër.

Dëshmitë duhet të jenë në formën e:

- vërtetimeve të lëshuara nga ente publike për përmbushjen me sukses të kontratave, ose
- faturave tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore.

Operatori ekonomik “E.P.M. S.R.L.” ka paraqitur disa dokumente që pretendojnë të vërtetojnë përvojën e mëparshme, konkretisht:

1. Dokument i datës 30.06.2025, i lëshuar nga Drejtoria e Shërbimit të Prokurimit, nën drejtimin e Denissa Romina Luisa Fabiano;
2. Dokument i dytë, datë 30.06.2025, lëshuar nga Drejtori i Shërbimit të Mbikëqyrjes dhe Kreu i Zyrës së Tenderit, Dr. Romina Luisa Fabiano (ASL CE Prot. nr. 0159477/PROVV);
3. Dokument i paqartë në datë, i paraqitur nga Integrated Services Consortium, me titull “Certificate of Service”;
4. Dokument i titulluar “Certificate ASL Napoli 1 Centro”, i lëshuar nga Azienda Sanitaria Locale Napoli 1 Centro, me datë 20.05.2024;
5. Një referencë e datës 04 korrik 2025, e lëshuar nga një subjekt publik italian pa lidhje me emrin “E.P.M. S.R.L.”.

Vlerësimi i dokumenteve të paraqitura

a) Dokumenti i datës 30.06.2025

Ky dokument, i lëshuar nga Drejtoria e Shërbimit të Prokurimit, nuk përmend asnjëherë operatorin ekonomik “E.P.M. S.R.L.” dhe nuk vërteton realizimin e shërbimeve nga ky operator. Për pasojë, nuk mund të pranohet si dëshmi për përvojën e mëparshme.

b) Dokumenti i dytë i datës 30.06.2025 (ASL CE Prot. nr. 0159477/PROVV)

Ky dokument, i nënshkruar nga Drejtori i Shërbimit të Mbikëqyrjes dhe Kreu i Zyrës së Tenderit, Dr. Romina Luisa Fabiano, nuk vërteton askund se shoqëria “E.P.M. S.R.L.” ka kryer apo realizuar ndonjë shërbim për këtë institucion. Subjekti nuk përmendet si ofrues i shërbimeve të kërkuara, ndaj dokumenti nuk mund të përdoret si dëshmi e përvojës së mëparshme.

c) Dokumenti i paraqitur nga “Integrated Services Consortium”

Dokument i që pretendon të vërtetojë shërbimet e kryera nga “E.P.M. S.R.L.” gjatë periudhës 2022–2024 nuk përmbush kërkesat e Dokumenteve të Tenderit për arsyet e mëposhtme:

- Nuk është i firmosur me nënshkrim fizik apo elektronik dhe nuk është vulosur nga ndonjë autoritet kompetent;
- Nuk është i firmosur nga përfaqësues i “E.P.M. S.R.L.”;

- Nuk përmban elemente që garantojnë autenticitetin apo vlefshmërinë ligjore;
- Është lëshuar në letër të thjeshtë (plain paper), pa asnjë element zyrtar.

Në këto kushte, dokumenti nuk mund të konsiderohet si provë e vlefshme për përmbushjen e kriterit të përvojës profesionale.

Dokumenti i lëshuar nga “Integrated Services Consortium”, me adresë në Milano, që pretendon se “E.P.M. S.R.L.” ka kryer shërbime pastrimi e higjienizimi në kuadër të një marrëveshjeje me ASL Napoli 1 (periudha 2022–2024), nuk mund të pranohet për arsyet:

1. Nuk është i firmosur apo i vulosur nga autoritet zyrtar;
2. Është lëshuar “on plain paper” dhe nuk përmban elemente autentike;
3. Pretendon të jetë “digitally signed”, por në dokumentin e dorëzuar nuk është e dukshme asnjë firmë dixhitale apo element verifikues;
4. Përbën vetëdeklarim të një subjekti privat dhe jo vërtetim publik;
5. Nuk ka numër protokolli, vulë ose datë regjistrimi.

Në mungesë të një dokumenti zyrtar të nënshkruar e të vulosur nga ent publik, dokumenti nuk mund të përdoret për përmbushjen e kriterit të përvojës.

Ky dokument, i lëshuar nga Azienda Sanitaria Locale Napoli 1 Centro, vërteton shërbimet e pastrimit e higjienizimit të kryera nga Consorzio Servizi Integrati, dhe jo nga “E.P.M. S.R.L.”. Në tekst thuhet qartë:

“This certification is issued to Consorzio Servizi Integrati... The specific turnover generated by the Consorzio Servizi Integrati...”

duke provuar se subjekti i vetëm përfitues është konsorciumi, por jo operatori “E.P.M. S.R.L.”.

Prandaj, dokumenti nuk provon se “E.P.M.” S.R.L. ka kryer shërbime të ngjashme gjatë periudhës së kërkuar.

Referenca e paraqitur nga një subjekt publik italian nuk përmend askund “E.P.M. S.R.L.” dhe nuk ka lidhje me këtë operator ekonomik. Si i tillë, nuk përbën provë të vlefshme për përvojën profesionale.

Në bazë të shqyrtimit të gjithë dokumentacionit të dorëzuar në SPE, konstatohet se:

- Asnjë nga dokumentet e paraqitura nuk është i firmosur, vulosur apo i verifikueshëm nga autoritet publik;
- Asnjë prej tyre nuk vërteton në mënyrë të drejtpërdrejtë realizimin e shërbimeve nga “E.P.M. S.R.L.”;
- Asnjë dokument nuk përmbush standardet ligjore të vlefshmërisë sipas Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe kërkesave të pikës 2.3.1 të Dokumenteve të Tenderit.

Në mungesë të dëshmive të vlefshme dhe zyrtare që vërtetojnë përvojën e kërkuar në shërbime të ngjashme gjatë tre viteve të fundit, operatori ekonomik “E.P.M. S.R.L.” nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit, pika 2.3.1 e Dokumenteve të Tenderit.

Për rrjedhojë, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave skualifikon operatorin “E.P.M. S.R.L.” nga procedura e tenderit.

7. Shoqëria “E.P.M. S.R.L.” nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.3.3 të Dokumenteve të Standardizuara të Tenderit (DST), pasi nuk ka paraqitur licencën përkatëse të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit me Kodin II.8.A – “Shërbime ekspertize higjiëno-shëndetësore.”

Në kriteret e veçanta të kualifikimit është përcaktuar qartë se:

“Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.”

Në rastin konkret, operatori ekonomik nuk ka paraqitur as licencën e kërkuar, as vetëdeklarimin që vërteton se dokumenti nuk lëshohet në vendin e origjinës. Për pasojë, dokumentacioni konsiderohet i paplotë dhe kriteri nuk përmbushet.

Gjithashtu, në Seksionin I – Udhëzime për Operatorët Ekonomikë, nën C. PARAQITJA, HAPJA DHE SHQYRTIMI I KËRKESAVE PËR PJESËMARRJE/OFERTAVE, pika 21 “Kualifikimi i operatorëve ekonomikë”, përcaktohet se:

“3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar për të gjitha kriteret për të cilat nuk lejohet vetëdeklarim.

Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit.

Në rastet e dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.”

Duke qenë se operatori ekonomik nuk ka dorëzuar licencën përkatëse dhe nuk ka provuar se një dokument i tillë nuk lëshohet në vendin e origjinës, ai nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar në dokumentet e tenderit.

8. Në kriteret e veçanta të kualifikimit është përcaktuar se:

“Operatorët ekonomikë, për kryerjen e shërbimit të pastrimit të ambienteve të jashtme e të brendshme, objekt prokurimi, duhet të kenë të punësuar minimumi 50 (pesëdhjetë) punonjës, si më poshtë:

Nr. Pozicioni i punës Numri i kërkuar i punonjësve

1 Përgjegjës Shërbimi 2

2 Punonjës pastrimi/sanitar 47

3 Shofer për drejtimin e mjeteve të kërkuara 1

Totali 50

Ofertuesi ka paraqitur ofertën si Bashkim Operatorësh Ekonomikë (BOE), i përbërë nga:

- “NRG” sh.p.k (15%)
- “Alben Pulito” sh.p.k (30%)
- “E.P.M.” S.R.L (55%)

Në përputhje me përqindjet e pjesëmarrjes në kontratë, numri minimal i kërkuar i punonjësve që secili operator duhet të vetëdeklarojë është si më poshtë:

Operator Ekonomik Përqindja e pjesëmarrjes Numri minimal i kërkuar i punonjësve pastrimi/sanitar Numri i vetëdeklaruar Përgjegjës shërbimi i vetëdeklaruar

NRG sh.p.k 15% 7.05 ≈ 7 7 0

Alben Pulito sh.p.k 30% 14.1 ≈ 14 16 1

E.P.M. S.R.L 55% 25.85 ≈ 26 25 0

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se operatori ekonomik “E.P.M.” S.R.L:

• Ka vetëdeklaruar 25 punonjës pastrimi/sanitar, ndërkohë që në përpjesëtim me pjesëmarrjen në kontratë duhej të vetëdeklaronte të paktën 26;

• Nuk ka vetëdeklaruar asnjë punonjës në pozicionin e “Përgjegjës të Shërbimit”, megjithëse kriteri kërkon që secili operator të provojë disponimin e këtij profili, në përpjesëtim me detyrimet e tij në ekzekutimin e kontratës.

Si perfundim, duke qenë se operatori “E.P.M.” S.R.L nuk ka përmbushur numrin minimal të punonjësve pastrimi/sanitar, dhe nuk ka deklaruar asnjë përgjegjës shërbimi, ai nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit 2.3.4.

Për rrjedhojë, Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (NRG sh.p.k – Alben Pulito sh.p.k – E.P.M. S.R.L) në tërësi nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit, dhe si i tillë nuk mund të kualifikohet për fazën e mëtejshme të procedurës së prokurimit.

9. Operatori ekonomik “E.P.M. S.R.L”, me pjesëmarrje 55% në kontratë, nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit, pikën 2.3.6, pasi nuk ka paraqitur deklaratën e kërkuar ku merr përsipër kryerjen e shërbimeve nga punonjës të pajisur me uniformën e punës dhe me materialet/pajisjet mbrojtëse personale për shëndetin dhe sigurinë teknike në punë.

Mungesa e këtij dokumentacioni është në kundërshtim me kërkesat e tenderit dhe çon në skualifikimin e operatorit nga faza e kualifikimit përkatës.

10. Dokumentacioni i paraqitur ne SPE nga operatori ekonomik “E.P.M. S.R.L”, nuk janë te legalizuara me Vule Apostile.

Nenit 26, pika 6, paragrafi 3 i VKM Nr.285, date 19.05.2021 “Per Rregullat e Prokurimit Publik” i ndryshuar, i cili përcakton se:

“Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.”

Në VKM nr. 134, datë 7.3.2003 “Për vërtetimin dhe legalizimin e dokumentave të lëshuara në Republikën e Shqipërisë, për përdorim jashtë vendit dhe të dokumentave të huaja, për përdorim brenda vendit”, në pikën 4 të tij përcaktohet se: “[...] Dokumentat e autoriteteve të huaja që do të përdoren brenda vendit, legalizohen në përfaqësitë e Republikës së Shqipërisë jashtë vendit ndërsa dokumentat e legalizuara nga përfaqësitë e akredituara në Tiranë, legalizohen në Ministrinë e Punëve të Jashtme”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton se, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik E.P.M. S.R.L si anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë (NRG sh.p.k – Alben Pulito sh.p.k – E.P.M. S.R.L), janë dokumenta pa vula apostile, në kundërshtim kjo me legjislacionin e referuar me sipër si edhe në kundërshtim me Konventën e Hagës (5 TETOR 1961) në kombinim me Ligjin nr.9060, date 8.5.2003 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja".

Kushti ligjor i pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit për operatorët ekonomik të huaj që kanë regjistrim në shtetet anetare të Konventës së Hagës (5 TETOR 1961), siç është edhe Italia, është që dokumentet e lëshuara duhet të përmbajnë vullen apostile në përputhje me ligjin nr. 9060, date 8.5.2003 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja". Shqipëria dhe Italia janë vende anetare (që kanë ratifikuar/aderuar) në Konventën e Hagës "Për heqjen e detyrimit të legalizimit të dokumenteve zyrtare të huaja" të 5 tetorit 1961, e për rrjedhim dokumentet e lëshuara nga institucionet shqiptare që do të përdoren në vendet anetare të se njëjtes Konvente, si dhe anasjelltas, nuk do të legalizohen nga përfaqësitë diplomatike e konsullore. Në bazë të

kesaj Konvente, dokumentet pajisen me nje vule Apostille nga autoriteti kompetent i vendit ku jane leshuar dokumentat (ne rastin konkret Italia), edhe me pas mund te perdoren direkt ne institucionin perkates te vendit prites (ne rastin konkret Shqiperia). Prandaj dokumentet qe origjinojne nga Italia, duhet te apostilohen para se te paraqiten prane autoriteteve shqiptare. Autoritetet pergjegjese per apostilimin e dokumenteve, ku përfshihet dhe shteti Italian, gjenden ne adresen: <https://www.hcch.net/en/instruments/conventions/authorities1/?cid=41>

Anetari i BOE-se “E.P.M. S.R.L” duhej te kishte ndjekur procedurat prane autoriteteve kompetente Italiane per pajisjen me vule Apostile te dokumentacionit te prodhuar ne shtetin Italian, perpara se ta paraqiste ate si pjese te ofertes ne proceduren e prokurimit (ne nje vend te huaj). Rrjedhimisht, dokumentacioni i paraqitur per te provuar plotesimin e kriterit te kualifikimit te, nuk rezultojne te jene ne perputhje me parashikimet ligjore ne fuqi te referuara me siper te cilat nuk diskutohen por zbatohen nga cdo operator ekonomik qe ka interes te marre pjese ne nje procedure prokurimi ne Shqiperi.

11. Kriteret ligjore dhe ato për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe legjislacionin ne fuqi dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente dhe dispozita ligjore ne fuqi duhet të refuzohen si të papranueshme.

Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve ligjore, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe neni 26, pika 6, paragrafi 3 i VKM Nr.285, date 19.05.2021 “Per Rregullat e Prokurimit Publik” i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin Shqiptar dhe ne dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dispozita ligjore Shqiptare dhe dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë i referuar me siper do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesave ligjore te prokurimit së mësipërme, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor, deri në 6 ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 75 i LPP-së. Në nenin 75, pika 1 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se “[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor

në dokumentet e tenderit [...]”. KVO gjykon se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret ligjore Shqiptare dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, për sa kohë që i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt-ankimimi. Kriteret ligjore dhe ato kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Komisioni Vleresimit të Ofertave, gjykon se bashkimi i operatorëve ekonomik (NRG sh.p.k – Alben Pulito sh.p.k – E.P.M. S.R.L) me dokumentacionin e dorëzuar nuk ka plotësuar kriteret ligjore dhe kualifikuese të referuar me sipër dhe për këto arsye skualifikohen.

“Alpen Pulito” Sh.p.k

1. Operatori ekonomik “Alpen Pulito” Sh.p.k, nuk ka përmbushur kriterin e veçantë të kualifikimit, pika 1, shkronja a), pasi në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit, Seksioni D – “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”, nuk ka specifikuar dokumentin apo adresën konkrete ku autoriteti kontraktor mund të verifikojë deklaratimet e mëposhtme:

- Garantimin e mbrojtjes së të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- Lidhjen e kontratave të punës dhe garantimin e masave të sigurisë e shëndetit në punë, veçanërisht për grupet e rrezikuara;
- Mungesën e masave ligjore në fuqi të vendosura nga ISHPSHSH, apo adresimin e tyre brenda afateve në rast shkeljesh të konstatuara.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Mungesa e informacionit për verifikim e bën të pamundur vërtetimin e deklaratimeve dhe përbën shkak për skualifikim nga procedura.

KVO konstaton që operatori ekonomik nuk ka paraqitur të dhëna, dokumenta referues dhe/ose adresat për plotësimin e të gjitha rubrikave të mësipërme. Qendrim ky i mbajtur dhe nga Komisioni i Prokurimeve Publike me ane të vendimit Nr.209/2025, date 07.02.2025, i cili ka theksuar se: “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit duhet të plotësohet në të gjithë seksionet e saj duke dhënë deklaruar adresën apo dokumentin konkret mbi bazën e të cilit autoriteti mund të bëjë verifikimin e vetëdeklarimeve dhe mosplotësimi i tij në të gjithë seksionet përkatëse përben kusht skualifikimi”.

Te njëjtin qendrim KPP ka mbajtur edhe me Vendimet Nr.816/2025, date 27.06.2025 dhe Nr.1264/2025, date 17.09.2025. Për sa me sipër operatori ekonomik skualifikohet.

2. Operatori ekonomik “Alpen Pulito” sh.p.k., me pjesëmarrje në përqindje 30% në bashkimin e operatorëve ekonomikë, nuk ka deklaruar numrin e mjeteve dhe pajisjeve në Shtojcën nr. 12 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pjesë integrale e dokumenteve të tenderit. Ky formular, sipas përcaktimeve të pikës 2.3.5 të Dokumenteve të Tenderit, përbën mjetin e vetëm të vlefshëm për vetëdeklarimin e kapaciteteve teknike, në këtë fazë të procedurës, pa detyrim për paraqitjen e dokumenteve provuese (aktet e pronësisë, kontratat e qirasë, etj.).

Në këtë kuadër, kërkesa e pikës 2.3.5 parashikon qartë se:

“Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas Shtojcës nr. 12 të Dokumenteve të Tenderit.”

Gjithashtu, kriteri përcakton në mënyrë të detajuar se operatorët ekonomikë duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme në pronësi, me qira ose në përdorim:

Nr. Emri i mjetit Njësia Sasitë minimale Statusi

- 1 Makineri larëse-tharëse për ambientet e brendshme Copë 2 Në pronësi, me qira ose në përdorim
- 2 Makineri larëse për të gjitha llojet e shtresave (mokset, beton, laminat, etj.) Copë 2 Në pronësi, me qira ose në përdorim
- 3 Pajisje për larje në lartësi deri në 20 m me ujë të purifikuar Copë 1 Në pronësi, me qira ose në përdorim
- 4 Pompa spërkatëse me mjegull të ftohtë, për aplikimin e kimikateve dezinfektues Copë 10 Në pronësi, me qira ose në përdorim
- 5 Kosh transporti mbetjesh i madh, i posaçëm, i mbyllur me kapakë Copë 20 Në pronësi, me qira ose në përdorim
- 6 Karrelë për pastrimin me të gjitha mjetet e nevojshme Copë 20 Në pronësi, me qira ose në përdorim
- 7 Makinë për larjen e rrugëve (autobot), me kapacitet min. 5000 L Copë 1 Në pronësi, me qira ose në përdorim
- 8 Fshesë me vakum elektrike për rrugë Copë 2 Në pronësi, me qira ose në përdorim

Në mungesë të deklaramit të numrit të mjeteve dhe pajisjeve, operatori “Alpen Pulito” sh.p.k. nuk ka plotësuar në mënyrë të plotë formularin e vetëdeklarimit, gjë që pengon autoritetin kontraktor të verifikojë përmbushjen e kërkesave minimale të këtij kriteri teknik.

Ky veprim përbën mospërmbushje materiale të kërkesës së parashikuar në pikën 2.3.5 të DT-së, si dhe në nenin 88, pika 3, të VKM nr. 285/2021, i cili kërkon që çdo anëtar i BOE-së të përmbushë kriteret teknike dhe profesionale në përputhje me përqindjen dhe natyrën e pjesëmarrjes në kontratë.

Në praktikën administrative të Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) dhe Komisionit të Prokurimit Publik (KPP), një formular vetëdeklarimi i paplotësuar në elementët thelbësorë (si numri i mjeteve/pajisjeve) konsiderohet mangësi me ndikim në kualifikim, që nuk mund të korrigjohet pas hapjes së ofertave, pasi lidhet me vërtetimin e kapacitetit teknik.

3. Sipas pikës 2.3.8 të dokumenteve të tenderit, operatori ekonomik “Alpen Pulito” sh.p.k., për lëndët biocide, ku kerkohet:

“Operatori ekonomik duhet të provojë se është i autorizuar nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar prej tyre, për lëndët biocide (nëse ofron një të tillë) që do të përdoren gjatë kryerjes së shërbimit objekt prokurimi. Nëse autorizimi paraqitet nga një distributor i autorizuar, duhet të vërtetohet lidhja ndërmjet këtij distributori dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit (telefon, e-mail, website), të nevojshme për verifikim nga Autoriteti Kontraktor.”, ka paraqitur Autorizim për tregtim mallrash të prodhuara nga kompania italiane ITALCHIMICA, datë 11.03.2022 dhe Autorizimin date 08.03.2025, të lëshuar nga kompania “MARI” sh.p.k., Durrës. Nga verifikimi rezulton se në momentin e lëshimit të ketyre autorizimeve, kompania “MARI” sh.p.k. nuk kishte asnjë kontratë apo marrëveshje bashkëpunimi të vlefshme me prodhuesin italian ITALCHIMICA.

Në vijim, konstatohet se shoqëria “MARI” sh.p.k. ka patur dy kontrata shitblerjeje me kompaninë ITALCHIMICA, me afat 01.01.2023 – 31.12.2023 dhe me afat 01.01.2024 – 31.12.2024.

Pra, në datën 11.03.2022 dhe në datën 08.03.2025, kur janë lëshuar autorizimet për “Alpen Pulito” sh.p.k., nuk ekzistonte një marrëdhënie kontraktuale e vlefshme midis “MARI” sh.p.k. dhe prodhuesit ITALCHIMICA.

Si rrjedhojë, autorizimet e datave 11.03.2022 dhe 08.03.2025 janë të pavlefshme, pasi janë lëshuar në mungesë të bazës ligjore dhe kontraktuale që të mbështesë të drejtën e “MARI” sh.p.k. për të autorizuar palë të treta.

Gjithashtu, operatori ekonomik nuk ka paraqitur ndonjë autorizim të ri apo konfirmim nga prodhuesi që të vërtetojë vlefshmërinë aktuale të përdorimit të këtyre produkteve.

Akoma me tej, KVO ka konstatuar se Shoqëria “MARI” sh.p.k. ka pasur dy kontrata shitblerjeje me kompaninë ITALCHIMICA dhe jo ndonjë kontratë/marrveshje distribucioni që do i jepte të drejtën shoqërisë “MARI” sh.p.k. për të lëshuar Autorizime për palet të treta si në rastin konkret. Në përfundim, për shkak të mungesës së një autorizimi të vlefshëm në kohë dhe pasi Lendet Biocide e paraqitura nuk janë të bazuara në një marrëdhënie kontraktuale, për më tepër edhe ato dy marrëdhënie kontraktuale janë të skaduara më 31.12.2023 dhe 31.12.2024, operatori ekonomik “Alpen Pulito” sh.p.k. nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.3.8 të dokumenteve të tenderit. Për pasojë, oferta e operatorit ekonomik duhet të konsiderohet e pavlefshme për këtë kriter, në përputhje me Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimet Publike”, për shkak të mospërmbushjes së kërkesave teknike të detyrueshme.

“NRG” Sh.p.k

1. Operatori ekonomik “NRG” Sh.p.k. nuk ka përmbushur kriterin e veçantë të kualifikimit, pika 1, shkronja a), pasi në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit, Seksioni D – “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”, nuk ka specifikuar dokumentin apo adresën konkrete ku autoriteti kontraktor mund të verifikojë deklaratimet e mëposhtme:

- Garantimin e mbrojtjes së të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- Lidhjen e kontratave të punës dhe garantimin e masave të sigurisë e shëndetit në punë, veçanërisht për grupet e rrezikuara;
- Mungesën e masave ligjore në fuqi të vendosura nga ISHPSHSH, apo adresimin e tyre brenda afateve në rast shkeljesh të konstatuara.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Mungesa e informacionit për verifikim e bën të pamundur vërtetimin e deklaratimeve dhe përbën shkak për skualifikim nga procedura.

KVO konstaton që operatori ekonomik nuk ka paraqitur të dhëna, dokumenta referues dhe/ose adresat për plotësimin e të gjitha rubrikave të mësipërme. Qëndrim ky i mbajtur dhe nga Komisioni i Prokurimeve Publike me ane të vendimit Nr.209/2025, datë 07.02.2025, i cili ka theksuar se: “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit duhet të plotësohet në të gjithë seksionet e saj duke dhënë deklaruar adresën apo dokumentin konkret mbi bazën e të ciles/cilit autoriteti mund të bëjë verifikimin e vetëdeklarimeve dhe mosplotësimi i tij në të gjithë seksionet përkatëse përben kusht skualifikimi”.

Te njejtin qendrim KPP ka mbajtur edhe me Vendimet Nr.816/2025, date 27.06.2025 dhe Nr.1264/2025, date 17.09.2025. Per sa me siper operatori ekonomik skualifikohet.

2. Në zbatim të nenit 88 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet se në rastet kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë (BOE), duhet që në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet palëve të përcaktohet qartë pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit që do të kryejë secili prej anëtarëve të bashkimit. Kjo dispozitë ka karakter urdhërues dhe përbën një element thelbësor për vlerësimin e përgjegjësisë dhe kapaciteteve të secilit operator brenda bashkimit.

Në rastin konkret, bashkimi i operatorëve ekonomikë “NRG” sh.p.k, “Alpen Pulito” sh.p.k dhe “E.P.M” S.r.l ka paraqitur një kontratë bashkëpunimi, datë 20.10.2025, në të cilën është bërë ndarja e përqindjeve të pjesëmarrjes (NRG sh.p.k – 15%, Alpen Pulito sh.p.k – 30%, E.P.M S.r.l – 55%), por nuk është përcaktuar pjesa konkrete e shërbimit, punës apo furnizimit që do të realizojë secili anëtar i bashkimit. Kjo mospërputhje përbën shkelje të drejtpërdrejtë të nenit 88, pika 1, të VKM nr. 285/2021, pasi ligji kërkon shprehimisht që kontrata e bashkëpunimit të përmbajë ndarjen funksionale të punëve ose shërbimeve ndërmjet anëtarëve të BOE-së, si kusht i vlefshmërisë së ofertës dhe i përcaktimit të përgjegjësive kontraktore.

Për pasojë, kontrata e bashkëpunimit e paraqitur nga BOE është e pavlefshme, pasi bie në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit, sipas nenit 92, pika “a”, të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, i cili përcakton se:

“Veprimet juridike të pavlefshme nuk krijojnë asnjë pasojë juridike. Të tilla janë ato që vijnë në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit.”

Në këtë kuptim, mungesa e përcaktimit të detajuar të pjesëve të shërbimit për secilin operator ekonomik brenda BOE-së e bën kontratën e bashkëpunimit të paplotë në përmbajtje, të kundërligjshme në formë, dhe rrjedhimisht të pavlefshme në kuptim juridik, duke mos prodhuar asnjë efekt ligjor ndaj autoritetit kontraktor.

Si rezultat, oferta e paraqitur nga ky bashkim operatorësh nuk mund të konsiderohet e vlefshme për qëllime të mëtejshme të procedurës së prokurimit publik.

3. Operatori ekonomik “NRG” sh.p.k., me pjesëmarrje në përqindje 15%, dhe operatori “E.M.P.” S.r.l., me pjesëmarrje në bashkimin e operatorëve ekonomikë në masën 55%, nuk kanë deklaruar asnjë mjet dhe asnjë pajisje në Shtojcën nr. 12 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pjesë integrale e dokumenteve të tenderit.

Ky veprim përbën mospërmbushje të detyrimit ligjor të përcaktuar në nenin 88, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i cili rregullon mënyrën e pjesëmarrjes së bashkimeve të operatorëve ekonomikë (BOE) në procedurat e prokurimit. Në mënyrë të posaçme, pika 1 e këtij neni kërkon që: “Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.”

Ndërsa pika 3 e po këtij neni parashikon në mënyrë shteruese dhe detyruese se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76 të LPP-së dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.”

Në këtë kuptim, çdo anëtar i BOE-së ka detyrimin të marrë përsipër dhe të vërtetojë kapacitetet teknike dhe profesionale që i korrespondojnë pjesëmarrjes së tij ne perqindje dhe ne natyrën e shërbimit që do të kryejë, në përputhje me kriteret e veçanta të kualifikimit të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit, konkretisht në pikën 2.3.4, që kërkon disponimin e mjeteve dhe pajisjeve specifike për kryerjen e shërbimeve të kontraktuara.

Gjithashtu, mungesa e plotësimit dhe nënshkrimit të Shtojcës nr. 12 nga anetari tjetër i BOE operatori “E.M.P.” S.r.l. tregon se ky subjekt nuk ka marrë përsipër detyrimet përkatëse që rrjedhin nga kriteri teknik, si dhe nuk ka bërë shprehje të vlefshme të vullnetit juridik në raport me kapacitetet që kërkon kontrata. Duke qenë se dispozitat e nenit 88, pika 1 dhe 3, kanë natyrë urdhëruese, mosrespektimi i tyre përbën shkelje materiale të rregullave të prokurimit publik dhe bën të pavlefshme ofertën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë.

Në përfundim të vlerësimit, konstatohet se Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “NRG” sh.p.k., “Alpen Pulito” sh.p.k. dhe “E.M.P.” S.r.l.:

- Dy prej anëtarëve të tij, “NRG” sh.p.k. dhe “E.M.P.” S.r.l., nuk kanë deklaruar asnjë mjet apo pajisje në Shtojcën nr. 12 ne perputhje me perqindjen e shërbimit te marre persiper ne kontraten e bashkepunimit;
- Nuk kanë përmbushur detyrimin për të vërtetuar kapacitetet teknike sipas perqindjes dhe natyrës së pjesëmarrjes në kontratë.

Për rrjedhojë, BOE nuk përmbush kriteret e kualifikimit të parashikuara në nenin 88, pika 1 dhe 3, të VKM nr. 285/2021, si dhe në pikën 2.3.4 të Dokumenteve të Tenderit.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konkludon se oferta e paraqitur nga ky BOE është e pavlefshme dhe per keto arsye skualifikohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, informojmë se, operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si ofertues i sukseshëm:

1. Operatori ekonomik “AIR”

me NIPT: L51712008C

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Me subjekt mbështetës:

Operatori ekonomik “S I L V E R”, me NIPT: K88010301S

Vlera e ofruar: 243,017,617.96 (dyqind e dyzetë e tre milion e shtatëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë pikë nëntëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Totali i pikëve të marra _____

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.